3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të



paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) Janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinarë shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe



Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 218, datë 2.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 295, datë 17.3.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) mishit të freskët;
- ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521

sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- i. 65°C në 39.8 sekonda;
- ii. 70°C në 3.6 sekonda;
- iii. 74°C në 0.5 sekonda;
- iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Bayern	Erding	Steinkirchen*
2.	Brandenburg	Oder-Spree	Neuzelle*
3.	Bayern	Erding	Bockhorn*
4.	Brandenburg	Dahme-Spreewald	Bestensee*
5.	Bayern	Mühdorf am Inn	Neumarkt-Sankt Veit*
6.	Brandenburg	Dahme-Spreewald	Königs Wusterhausen*
7.	Bayern	Rottal-Inn	Gangkofen*
8.	Brandenburg	Spree-Neiße	Neuhausen/Spree*
9.	Brandenburg	Oder-Spree	Spreehagen*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Gjermanisë, të cilat nuk kanë pasur njohim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinarë garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve



të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 273, datë 11.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 296, datë 17.3.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65°C në 39.8 sekonda;

ii. 70°C në 3.6 sekonda;

iii. 74°C në 0.5 sekonda;

iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2.	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3.	Śląskie	Gliwice	Toszek*
4.	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
5.	Podlaskie	Białystok	Łapy*
6.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
7.	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chelmża (rural)*
8.	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
9.	Podkarpackie	Przemyśl	Krasieczyn*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
11.	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
12.	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
13.	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
14.	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
15.	Mazowieckie	Wolomin	Tłuszcz*
16.	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
17.	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
18.	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
19.	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
20.	Pomorskie	Malbork	Miloradz*
21.	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
22.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
23.	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
24.	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
25.	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
26.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
27.	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*



28.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
29.	Podkarpackie	Mielec	Radomysl Wielki*
30.	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
31.	Podlaskie	Mońki	Goniadz*
32.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
33.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
34.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
35.	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
36.	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
37.	Wielkopolskie	Leszno	Wijewo*
38.	Zachodniopomorskie	Białogard	Białogard (rural)*
39.	Podlaskie	Mońki	Knyszyn*
40.	Podlaskie	Sokółka	Janów*
41.	Opolskie	Opole	Niemodlin*
42.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jonkowo*
43.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
44.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
45.	Wielkopolskie	Nowy Tomysl	Miedzichowo*
46.	Wielkopolskie	Rawicz	Miejska Górka*
47.	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
48.	Zachodniopomorskie	Gryfino	Gryfino*
49.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
50.	Wielkopolskie	Nowy Tomysl	Opalenica*
51.	Małopolskie	Dąbrowa	Olesno*
52.	Podlaskie	Mońki	Krypno*
53.	Wielkopolskie	Szamotuły	Duszyniki*
54.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
55.	Mazowieckie	Maków	Plonawy-Bramura*
56.	Zachodniopomorskie	Koszalin	Sianów*
57.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
58.	Wielkopolskie	Kalisz	Lisków*
59.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Bytów*
60.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Nowe Miasto Nad Wartą*
61.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurztnik*
62.	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*
63.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
64.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Osięciny*
65.	Dolnośląskie	Milicz	Krośnice*
66.	Wielkopolskie	Kalisz	Kozminiek*
67.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Lubawa (rural)*
68.	Łódzkie	Skiermiewice	Lipce Reymontowskie*
69.	Łódzkie	Sieradz	Goszczanów*
70.	Wielkopolskie	Śrem	Śrem*
71.	Wielkopolskie	Leszno	Rydzyna*
72.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
73.	Łódzkie	Łowicz	Zduny*
74.	Wielkopolskie	Szamotuły	Kaźmierz*
75.	Wielkopolskie	Pleszew	Goluchów*
76.	Mazowieckie	Płock (City)	Płock*
77.	Lubuskie	Nowa Sól	Bytom Odrzański*
78.	Zachodniopomorskie	Kamień	Golczewo*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe

kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njofim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinarë garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuar para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 229, datë 3.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

**URDHËR****Nr. 297, datë 18.3.2026****PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE,
TË SHFAQUR NË SHTETIN E GREQISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, e tranzitimit nga i gjithë territori i Republikës së Greqisë në territorin e Republikës së Shqipërisë:

a) të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra;

b) të materialit biologjik të pa shoqëruar me test diagnostik PCR të rezultuar negativ, e bashkëlidhur certifikata shëndetësore veterinare, të kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;

c) mishin e freskët;

ç) produktet e mishit të patrajuara me të paktën me një temperaturë prej 70°C, për 30 minuta;

d) qumështin dhe produktet e qumështit të patrajuara termikisht me një temperaturë minimale prej 72°C për 15 sekonda (temperaturë e lartë – kohë e shkurtër pasterizimi (HTST) e aplikuar 2 herë) ose çdo trajtim tjetër ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;

dh) leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të papërpunuara të patrajuara ose papërpunuara ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;

e) ushqimit me përmbajtje proteinike dhe ushqimi i kafshëve ruminantë dhe derra të patrajuar termikisht ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

3. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra, materialit biologjik, embrioneve, mishin e freskët, produktet dhe nënprodukteve të tyre, qumështin, produktet e qumështit, ushqimit me përmbajtje proteinike, leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të patrajuara dhe të papërpunuara dhe të ushqimit të kafshëve ruminantë dhe derra.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

**VENDIM
Nr. 5, datë 26.1.2026****NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 18.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (Z) 2025 të Regjistrimit Themeltar që u përket:

KËRKUES: Zoica Lina, Ilirjan Lina, përfaqësuar nga avokati Kostandin Trandafili, me prokurë.



SUBJEKT I INTERESUAR:

Shoqëria e Sigurimeve “Intersig Vienna Insurance Group” sh.a., përfaqësuar nga avokatja Dorina Mustafaraj, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 6791, datë 11.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 730, datë 4.4.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024- 3871 (394), datë 26.6.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1 shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit 12 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuësve Zoica dhe Ilirjan Lina (*kërkuësit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, shoqërisë së sigurimeve “Intersig Vienna Insurance Group” sh.a. (*shoqëria e sigurimeve*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësit janë familjarët e trashëgimlënësit Kristaq Lina, që ka qenë bashkëshorti i kërkuësës dhe i ati i kërkuësit, ndërsa Julian Lina ka qenë respektivisht djali i kërkuësës dhe vëllai i kërkuësit. Në datën 9.4.2007 ata kanë qenë duke udhëtuar me biçikletë në aksin rrugor Seman-Fier, kur janë goditur nga një automjet i drejtuar nga shtetasi A.K. Si pasojë e këtij aksidenti, një muaj më pas, në datën 8.5.2007, Kristaq Lina ka humbur jetën. Ndërsa Julian Lina fillimisht ka pësuar dëmtime të rënda të klasifikuara si plagosje e rëndë, duke humbur plotësisht aftësinë për punë dhe më pas, në datën 10.3.2011, ai ka kryer vetëvrasje.

2. Në vijim të aksidentit të ndodhur është zhvilluar një proces gjyqësor penal ndaj shtetasit A.K. (drejtuesi i automjetit), duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal (*KP*). Gjatë procesit gjyqësor penal, nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është caktuar edhe një ekspert mjeko-ligjor, që ka arritur në përfundimin se shkak i vdekjes së shtetasit Kristaq Lina ka qenë përplasja me makinë. Nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor për shtetasin Julian Lina janë evidentuar politrauma me gjendje shoku traumatik, tronditje e rëndë e trurit e shoqëruar me koma cerebrale traumatike dhe dëmtime të tjera, që të gjitha së bashku kanë qenë të rrezikshme për jetën. Për shtetasin A.K., me vendim përfundimtar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është vendosur deklarimi fajtor për kryerjen e veprës penale shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, duke u dënuar përfundimisht, në aplikim të gjykimit të shkurtuar, me 3 vjet e 4 muaj burgim. Në bazë të nenit 59 të *KP*-së është vendosur pezullimi i ekzekutimit të dënimit, duke u vënë në shërbim prove për një afat prej 3 vjetësh.

3. Automjeti i drejtuar nga shtetasi A.K., që ka shkaktuar aksidentin, ka qenë i siguruar pranë shoqërisë së sigurimit/subjekti i interesuar me policën e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësi ndaj palëve të treta me afat nga 22.4.2006 deri në 21.4.2007. Duke qenë se aksidenti ka ndodhur në datën 9.4.2007, dëmi i ardhur si pasojë e tij do të mbulohej nga polica e sigurimit.

4. Për kërkimin e shpërblimit të dëmit të shkaktuar si pasojë e aksidentit, kërkuësit në datën 2.4.2009 i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadë me objekt detyrimin e subjektit të interesuar/shoqërisë së sigurimit për të paguar në favor të tyre dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe shpenzimet e tjera të arsyeshme e të nevojshme në shumën totale 24.516.263 lekë, kamatëvonesat për shkak të dëmit të shkaktuar nga aksidenti, që sipas tyre ishte në shumën 7.595.286 lekë, si dhe interesat ditore mbi këtë shumë deri në ekzekutim. Eksperti i caktuar nga gjykata e shkallës së parë për nxjerrjen e vlerës financiare për dëmin pasuror dhe jopasuror i është referuar dekretit nr. 295, datë 15.9.1992, “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” (*dekreti nr. 295/1992*),



rregullores nr. 622/1, datë 15.12.1992, “Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” (*rregullorja nr. 622/1, datë 15.12.1992*) dhe vendimit unifikues nr. 12, datë 14.9.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 12/2007*). Gjykata e shkallës së parë në përcaktimin e vlerës së dëmshpërblimit i është referuar vlerës së pensionit mesatar në vend. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 487, datë 27.1.2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe detyrimin e shoqërisë së sigurimit të dëmshpërblejë kërkuesit/paditësit për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga vdekja e shtetasit Kristaq Lina në shumën 6.124.757 (gjashtë milionë e njëqind e njëzet e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë. Detyrimin e palës së paditur/shoqërisë së sigurimit që të dëmshpërblejë kërkuesit për dëmin pasuror dhe jopasuror të Julian Linës në shumën 4.244.291 (katër milionë e dyqind e dyzet e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) lekë. Ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për kamatëvonesat, pasi kërkuesit i janë drejtuar drejtpërdrejt gjykatës pa shteruar rrugën jashtëgjyqësore.

5. Pas ankimit të të dyja palëve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2960, datë 18.12.2012, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 487, datë 27.1.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se gjatë gjykimit në shkallë të parë nuk janë marrë prova thelbësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, si dhe akti i ekspertimit mbi të cilin gjykata ka mbështetur vendimin është në kundërshtim me dispozitat procedurale, sepse pavarësisht se Julian Lina ka ndërruar jetë gjatë gjykimit të zhvilluar në shkallën e parë (në datën 10.3.2011), ajo e ka thirrur si palë në proces.

6. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka bërë kalimin procedural për Julian Linën, sipas nenit 199 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), duke vijuar gjykimin me nënën e tij/kërkuesen Zoica Lina. Referuar nenit 185 të KPC-së, kërkuesit në datën 1.4.2014 kanë shtuar objektin e padisë, duke i shtrirë kërkimet edhe për Julian Linën dhe duke kërkuar dëmin pasuror e jopasuror për shkak të vdekjes së tij, pasi fillimisht ishte kërkuar vetëm shpërblimi për paaftësinë e plotë. Në këto kushte, kërkuesit kanë kërkuar dëmshpërblimin nga

shoqëria e sigurimeve, në referim të nenit 13 të dekretit nr. 295/1992, sipas së cilit personi i dëmtuar ka të drejtë të kërkojë drejtpërdrejt nga shoqëria siguruese, brenda kufijve të përgjegjësisë së tij sipas kontratës së sigurimit, shpërblimin e dëmit. Gjithashtu, kërkuesit kanë kërkuar edhe kamatëvonesat.

7. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6791, datë 11.6.2014 (*vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*) ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe detyrimin e shoqërisë së sigurimit të dëmshpërblejë kërkuesit për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar si pasojë e vdekjes së shtetasve Kristaq Lina e Julian Lina në shumën totale 20.207.083 lekë (njëzet milionë e dyqind e shtatë mijë e tetëdhjetë e tre), e cila është ndarë si vijon: i. kërkuesit janë dëmshpërblyer bashkërisht me shumën 2.269.270 (dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë si dëm pasuror të pësuar nga vdekja e Kristaq Linës; ii. kërkuesja Zoica Lina është dëmshpërblyer në shumën 3.126.957 lekë (tre milionë e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) si dëm pasuror (moral dhe ekzistencial) të pësuar nga vdekja e bashkëshortit; iii. kërkuesi Ilirjan Lina është dëmshpërblyer në shumën 1.563.478 lekë (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) si dëm pasuror (moral dhe ekzistencial) të pësuar nga vdekja e të atit; iv. Zoica Lina dhe Ilirjan Lina janë dëmshpërblyer bashkërisht në shumën 2.772.897 lekë (dy milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) si dëm pasuror dhe jopasuror (moral dhe ekzistencial), të pësuar për shkak të paaftësisë së plotë të Julian Linës; v. kërkuesit janë dëmshpërblyer bashkërisht me shumën 3.171.280 lekë (tre milionë e njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë) si dëm pasuror të pësuar nga vdekja e Julian Linës; vi. kërkuesja Zoica Lina është dëmshpërblyer në shumën 4.868.801 lekë (katër milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e një) si dëm pasuror (moral dhe ekzistencial) të pësuar nga vdekja e Julian Linës; vii. kërkuesi Ilirjan Lina është dëmshpërblyer në shumën 2.434.400 lekë (dy milionë e katërqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind) si dëm pasuror (moral dhe ekzistencial) të pësuar nga vdekja e të vëllait. Për kërkimin e kamatëvonesave, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin, pasi kërkuesit



nuk kishin shteruar rrugën administrative, por edhe proceduralisht ky kërkim nuk ka ndodhur që në fillim të gjykimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka arsyetuar se në rastin konkret zbatohet dekreti nr. 295/1992, si dhe dispozitat (nenet 608, 609, 625, 641 dhe 643) e Kodit Civil (KC-së), pasi rasti ka ndodhur në datën 9.4.2007. Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” (ligji nr. 10076/2009) ka dalë më vonë dhe nuk ka fuqi prapavepruese.

8. Pas ankimit të kërkuësve dhe shoqërisë së sigurimit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 730, datë 4.4.2016 (*vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë*) ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke detyruar shoqërinë e sigurimit të dëmshpërblejë kërkuësit për dëmin pasuror dhe jopasuror në shumën totale 12.115.957 lekë (dymbëdhjetë milionë e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) dhe rrëzimin e kërimit për kamatëvonesat. Gjatë gjykimit, gjykata e apelit, në kushtet kur pretendimet e parashtruara në ankim nga pala e paditur kanë të bëjnë me faktorë determinues për përllogaritjen e dëmit pasuror dhe jopasuror, ka vendosur përsëritjen pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor dhe thirrjen e ekspertit për të dhënë shpjegime rreth aktit të ekspertimit të kryer në shkallë të parë dhe si pasojë kryerjen e shtesës së aktit të ekspertimit. Në llogaritjen e dëmit pasuror dhe jopasuror, eksperti është bazuar në dispozitat e KC-së, nenin 27 të rregullores nr. 622/1, datë 15.12.1992, si dhe vendimin unifikues nr. 12/2007.

9. Në datën 21.4.2016 kërkuësit kanë ushtruar rekurs dhe në datën 13.5.2016 shoqëria e sigurimit ka paraqitur kundërrkurs. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-3871 (394), datë 26.6.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë për kërkimin në lidhje me kamatëvonesat për shumën e dëmshpërblimit, duke detyruar shoqërinë e sigurimit të paguajë interesat për vlerën totale të dëmshpërblimit të caktuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, sipas normës së interesit bazë të depozitës sipas Bankës së Shqipërisë, duke filluar llogaritja nga data 1.4.2014 deri në momentin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë për pjesën tjetër të

kërkimeve. Gjykata e Lartë ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e Gjykatës së Apelit për ligjin e zbatueshëm, që, në rastin konkret, nisur nga koha e ndodhjes së aksidentit me pasojë vdekjen, janë dekreti nr. 295/1992 me ndryshimet përkatëse, rregullorja nr. 622/1, datë 15.12.1992, si dhe vendimi unifikues nr. 12/2007 (*shih paragrafin 41 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka gjetur të pabazuar në ligj qëndrimin e gjykatave më të ulëta për pagesën e kamatëvonesave, duke arsyetuar se llogaritja e kamatëvonesave në rastin konkret do të fillojë nga momenti i kërimit të tyre, data 1.4.2014, deri në momentin e ekzekutimit të vendimit nr. 730, datë 4.4.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka përcaktuar vlerën përkatëse të dëmshpërblimit. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se e drejta për të kërkuar kamatëvonesat është në vetvete një e drejtë me natyrë ligjore e nuk është e kushtëzuar me momentin kohor të ngritjes së padisë, dhe vetë i padituri ose përmbauesi gjyqësor në momentin e ekzekutimit duhet të llogarisë kamatëvonesat në bazë të përqindjes së normës bazë të interesit të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

10. Kërkuësit në datën 17.2.2025 i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës, gjatë shqyrtimit paraprak në datën 13.5.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në datën 19.11.2025 një gjyqtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, për shkak se kishte qenë në përbërjen e trupit gjykues që ka dhënë vendimin nr. 2960, datë 18.12.2012, me të cilin, mbi ankimin e të dyja palëve ndërgjyqëse, vendimi i gjykatës së shkallës së parë që kishte vendosur për themelin e çështjes është prishur dhe çështja është dërguar për rigjykim, ndërsa në vijim janë dhënë vendimet gjyqësore të kundërshtuara. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 19.11.2025, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke vlerësuar se gjyqtari gjendej përpara rastit të parashikuar në nenin 36, pika 1, shkronja ç”, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 18, pika 1, shkronja “ç”, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.



II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se gjatë procesit gjyqësor është cenuar:

11.1. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, i garantuar në nenin 18 të Kushtetutës*, pasi gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë i kanë mohuar trashëgimlënësit Julian Lina, për rrjedhojë edhe trashëgimtarëve të tij, vlerën e dëmit pasuror dhe biologjik për paaftësi të përhershme në punë nga dita e aksidentit deri ditën kur ai ka ndërruar jetë. Të miturit Julian Lina i është mohuar llogaritja e dëmit pasuror për paaftësi të plotë të përhershme nga viti 2007 deri në datën 10.3.2011 kur ka ndërruar jetë. Për më tepër, sipas rregullores nr. 53, datë 25.6.2009, “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” (rregullorja nr. 53/2009), parashikohet se dëmi biologjik duhet të llogaritet sikur ai të kishte jetuar. Eksperti gjatë gjykimit në shkallë të parë duke u bazuar në aktet në fuqi në momentin e aksidentit ka llogaritur dëmin pasuror dhe atë biologjik për paaftësi të plotë në punë 100% për periudhën 2007-2011, në një vlerë të caktuar. Gjykata e apelit ka riçelur hetimin gjyqësor dhe pa e kërkuar palët ka caktuar po të njëjtën ekspert. Gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se shtetasi Julian Lina nuk duhet të përfitonte shpërblimin e dëmit si pasojë e paaftësisë së plotë të përhershme për periudhën 2007-2011. Ajo e ka trajtuar ndryshe rastin për Julian Linën krahasuar me raste analoge për përcaktimin e dëmshpërblimit, duke i hequr mundësinë për të përfituar vlerën e dëmit pasuror dhe biologjik për periudhën kohore 2007-2011. Gjykata e apelit ka shkuar më tej kur ka arsyetuar se të ardhurat duhet të llogariten duke u bazuar në trefishin e pensionit minimal në fshat, duke paragjykuar të ndjerin Julian Lina që kishte moshën 16 vjeç në momentin e shkakut të dëmit, si anëtar të kooperativës bujqësore, kur në fakti duhet t’i referohej nenit 646 të KC-së dhe pagës minimale në shkallë vendi në kohën kur ka ndodhur aksidenti. Gjykatat kanë diskriminuar edhe kërkuesin Ilirjan Lina për vlerën e shpërblimit të dëmit jopasuror, me arsyetimin se dhimbja nuk është e njëjtë me atë të nënës. Trashëgimlënësit Julian Lina nuk i është njohur e drejta e përfitimit të dëmit pasuror për paaftësi të plotë dhe është diskriminuar në kundërshtim me

vendimin unifikues nr. 12/2007 dhe nenin 18 të Kushtetutës.

11.2. *Parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka realizuar funksionin e saj rishikues dhe kontrollues ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta në përputhje me ligjin, duke ligjëruar shkeljet e tyre. Kërkuesit kanë ushtruar rekurs në datën 21.4.2016 dhe sipas nenit 472 të KPC-së në fuqi në atë kohë palët ushtrojnë rekurs për çdo shkelje të ligjit. Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve për shkak të rëndësisë së saj. Gjykata e Lartë nuk ka vepruar sipas ligjit të kohës dhe ka kufizuar të drejtën e aksesit, duke mos u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs për shkeljet e kryera nga gjykata e apelit në drejtëm të parimit të kontradiktoritetit, disponibilitetit, së drejtës për t’u dëgjuar dhe parimit të paanshmërisë, pasi kërkuesit nuk kanë pasur mundësi për të debatuar rreth caktimit të detyrave të ekspertit dhe ata kanë kërkuar përjashtimin e trupit gjyqësor dhe të ekspertit.

11.3. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, sepse nuk ka arsyetuar për pretendimet e ngritura në rekurs që lidheshin me zbatimin e ligjit në kohën kur ka ndodhur aksidenti dhe qëndrimin e saj që ka vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së apelit. Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka dhënë konkluzione kategorike, pa argumente ligjore, duke keqinterpretuar ligjin dhe faktet.

11.4. *E drejta e pronës, pritshmëritë e ligjshme dhe parimi i sigurisë juridike*, pasi në konceptin e pronës përfshihen të drejta dhe interesa të tjerë që përbëjnë asete, pra pasuri. Kërkuesit kanë pasur pritshmëri të ligjshme për dëmin pasuror, duke u bazuar në dekretin nr. 295/1992 dhe praktikën gjyqësore për rastet e sigurimit, gjë që përbën pritshmëri të ligjshme për një interes pasuror të ardhshëm. Për dëmin jopasuror kërkuesit kanë pasur pritshmëri të ligjshme, duke u bazuar në vendimin unifikues nr. 12/2007, që plotësoi boshllëkun ligjor duke vendosur se trashëgimtarët e personave që kanë humbur jetën në aksident kanë të drejtë të përfitojnë dëm jopasuror. Gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë kanë mbajtur qëndrime kontradiktore për vlerën e dëmshpërblimit që u takon kërkuesve, pasi ato gjykata kanë interpretuar në mënyrë të gabuar dekretin nr. 295/1992, KC-në, udhëzimin e ministrit të Financave dhe ligjin nr. 10076/2009.



12. **Subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimeve**, ka paraqitur prapësime me shkrim si vijon:

12.1. *Pretendimet për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit dhe parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj* janë të pabazuara, pasi Gjykata e Lartë ka vlerësuar se në rastin konkret gjen zbatim dekreti nr. 295/1992, me ndryshimet përkatëse të bëra nga rregullorja nr. 622/1, datë 15.12.1992, duke mos u cenuar as parimi i barazisë përpara ligjit. Gjykata e Lartë ka dhënë një vendim duke argumentuar çdo pretendim të kërkuarve. Pretendimet e paraqitura nga kërkuarët lidhen me aspekte të hetimit gjyqësor dhe vlerësimin e provave shkencore me ekspert. Edhe gjykata e apelit ka vepruar duke respektuar dispozitat procedurale për hetimin gjyqësor.

12.2. *Pretendimi për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe sigurisë juridike* është tërësisht i pambështetur në ligj, pasi nuk ka pasur asnjë moment që gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë të kenë pasur paqartësi ose problematikë që lidhet me gjykimin ose kompetencat e tyre. Argumenti i kërkuarve se ky parim është cenuar vetëm për faktin se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit nuk përbën shkelje kushtetuese.

12.3. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës dhe pritshmërive të ligjshme* nuk është i bazuar. Kërkuarët gabojnë kur pretendojnë se duhet të përfitonin dëmshpërblim pasuror gjatë kohës së paafetësisë të të ndjerit Julian Lina, për shkak të pakësimit të të ardhurave të personit të paafte për punë. Në rastet kur i dëmtuari është i mitur duhet që humbja ose pakësimi i aftësisë për punë të ketë qenë e përhershme që të llogaritet dëmi pasuror, ndërsa në rastin konkret humbja e aftësisë për punë ka qenë për një periudhë kohe të caktuar, ku gjatë kësaj periudhe Julian Lina ka qenë i mitur dhe nuk mund të realizonte të ardhura edhe sikur të ishte i aftë për punë.

12.4. *Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar. Sipas kërkuarve, legjislacioni i zbatueshëm për përlllogaritjen e dëmit duhet të ishte ai i kohës së vdekjes (viti 2011) dhe jo ai i vitit 2007, por ky pretendim është tërësisht i pambështetur në ligj. Gjykatat kanë zbatuar drejt legjislacionin e posaçëm në fuqi në kohën kur ka ndodhur aksidenti, konkretisht rregulloren nr. 622/1, datë 15.12.1992, ku në nenin 27 të saj parashikohet se e ardhura që duhet të merret

parasysh për llogaritjen e dëmshpërblimit nuk mund të jetë më e ulët se trefishi i shumës vjetore të pensionit më të ulët, sipas legjislacionit shqiptar për sigurimet shoqërore. Në rastin konkret, i ndjeri ka jetuar në fshat dhe sikurse ka referuar gjykata e apelit për përlllogaritjen e dëmit duhet të merret parasysh pensioni mesatar i përfituar në vitin 2007 dhe jo të ardhurat sipas vitit 2011. Edhe për këtë pretendim, çdo element i referuar nga kërkuarët lidhet me vlerësimin e gjykatave të faktit dhe të Gjykatës së Lartë, brenda kornizave të dhëna nga ligji material dhe procedural.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarve

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F”, 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuarët legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, pasi në cilësinë e trashëgimtarëve kanë qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual objekt kundërshtimi.

15. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ndaj ajo mund të kërkojë vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë*



11.3.2021; nr. 29, datë 30.3.2017; nr. 39, datë 6.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese).

16. Gjykata vlerëson se kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të juridiksionit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, për rrjedhojë ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë mban datën 26.6.2024. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues rezulton se vendimi është dërguar në adresën elektronike të avokatit të kërkuessve në datën 17.10.2024. Ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 17.2.2025, brenda afatit ligjor 4-mujor, për rrjedhojë kërkuessit legjitimohen *ratione temporis*.

18. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuessit kanë ngritur katër pretendime (*shih paragrafin 11*). Në lidhje me pretendimin për *cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, kërkuessit kanë parashtruar se në raste të tjera analoge gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë vepruar ndryshe nga rasti i tyre, megjithatë ata nuk kanë paraqitur ndonjë vendim gjyqësor konkret për të argumentuar këtë pretendim. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, kërkuessit kanë parashtruar se Gjykata e Lartë duhet ta kishte shqyrtuar rekursin e tyre në seancë gjyqësore me praninë e palëve, duke zbatuar ligjin procedural të kohës së paraqitjes së rekursit. Sipas kërkuessve, për këtë arsye atyre iu është cenuar nga Gjykata e Lartë e drejta për të marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimet lidhur me cenimin e parimit të kontradiktoritetit, disponibilitetit, së drejtës për t’u dëgjuar dhe parimit të paanshmërisë gjatë gjykimit në gjykatën e apelit.

20. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se pas datës 21.4.2016, kur kërkuessit kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, dispozitat e KPC-së kanë pësuar ndryshime përkatësisht me ligjet nr.

38/2017 dhe nr. 44/2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Në nenin 32 të ligjit nr. 44/2021 parashikohet se përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohen sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. Rekursitet e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në datën 26.6.2024 në marrjen e vendimit ka vepruar në përputhje me parimin *tempus regit processum*, duke zbatuar legjislacionin procedural në fuqi, ndaj pretendimi i kërkuessit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

21. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, kërkuessit kanë parashtruar, ndër të tjera, argumentin se Gjykata e Lartë nuk ka pasqyruar në vendimin e saj pretendimet e ngritura në rekurs për cenimin e parimit paanshmërisë gjatë gjykimit në gjykatën e apelit. Gjykata, nga përmbajtja e dosjes gjyqësore, konstaton se kërkuessit kanë kërkuar përjashtimin e trupit gjykues, për shkak të mendimeve dhe sjelljeve të njëanshme në mbrojtje të interesave të shoqërisë së sigurimit. Për këtë kërkesë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e datës 24.11.2015, ka vendosur rrëzimin, duke vlerësuar se pretendimet ishin të natyrës subjektive e nuk bazoheshin në asnjë provë, me anë të së cilës do të provoheshin rrethana për njëanshmëri të trupit gjykues. Po gjatë gjykimit, në gjykatën e apelit kërkuessit kanë kërkuar përjashtimin edhe të ekspertit, kërkesë që është rrëzuar gjatë seancës gjyqësore të datës 22.1.2016. Gjykata vëren se arsyetimi i vendimit të gjykatës së apelit që ka rrëzuar kërkesat e kërkuessve nuk përmban gabime të dukshme ligjore ose faktike, për rrjedhojë mospasqyrimi i pretendimit për paanshmërinë e trupit gjykues të gjykatës së apelit është i tillë që nuk vë në dyshim standardin e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë.

22. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuessve, Gjykata konstaton se në thelb ato kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në përlogaritjen e dëmit të shkaktuar si pasojë e humbjes së jetës së familjarëve të tyre. Në



këtë pikë, Gjykata evidenton se e drejta e jetës garantohej nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së. Ndërsa Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se në rast vdekjeje ose dëmtimi fizik të rrezikshëm për jetën, detyrimi pozitiv i shtetit, sipas nenit 2 të KEDNJ-së, duhet të konsiderohet se përfshin edhe krijimin e një sistemi gjyqësor efektiv dhe të pavarur, të aftë për t'i ofruar viktimës dëmshpërblim të përshtatshëm. Në rastet që kanë të bëjnë me shkaktimin e vdekjes nga pakujdesia, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse sistemi ligjor u ofron viktimave ose të afërmeve të tyre një mjet juridik në gjykimin civil, qoftë veçmas ose edhe në lidhje me një mjet juridik në gjykimin penal, duke mundësuar përcaktimin e çdo përgjegjësie dhe marrjen e çdo mjeti juridik civil të përshtatshëm (*shih Stanevi k. Bullgarisë, nr. 56352/14, datë 30.5.2023, § 51; Nicolae Virgiliu Tănase k. Rumanisë, nr. 41720/13, datë 25.6.2019, §§ 135, 157-59*).

23. Për sa më sipër, Gjykata, nisur nga thelbi i pretendimeve të kërkuësve dhe bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, çmon ta analizojë çështjen nëse sistemi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm u ka ofruar kërkuësve një gjykim të drejtë, si një mjet juridik në dispozicion nga sistemi ligjor për të përfituar dëmshpërblimin e përshtatshëm nga humbja e jetës së të afërmeve të tyre.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë

24. Kërkuësit kanë pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, sepse nuk ka arsyetuar për pretendimet e ngritura në rekurs që lidheshin me zbatimin e ligjit në kohën kur ka ndodhur aksidenti dhe qëndrimin e saj që ka vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së apelit. Gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë kanë mbajtur qëndrim kontradiktor për vlerën e dëmshpërblimit, pasi kanë interpretuar në mënyrë të gabuar dekreten nr. 295/1992, KC-në, udhëzimin e ministrit të Financave dhe ligjin nr. 10076/2009.

25. Subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimit, ka parashtruar se pretendimet e kërkuësve janë të pabazuara, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zbatuar drejt legjislacionin e posaçëm në fuqi në kohën kur ka ndodhur aksidenti, konkretisht rregulloren nr. 622/1, datë 15.12.1992. Sipas subjektit të interesuar, edhe Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje çdo pretendimi të parashtruar në

rekurs dhe vendimi respekton standardin e vendosur nga jurisprudenca kushtetuese. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës, ndër të tjera, parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 25, datë 23.4.2025; nr. 67, datë 6.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata evidenton se në rastet kur pretendohet se vendimet gjyqësore përmbajnë elemente arbitrariteti, nuk vihet në dyshim e drejta e gjykatave të zakonshme për të interpretuar ligjin për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë. Por duke pasur parasysh të drejtën e individit për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, si element përbërës i së drejtës për një gjykim të drejtë, si dhe duke u kujdesur për të mos marrë trajtën e një gjykimi të zakonshëm të shkallës së katërt, për t'u dhënë përgjigje pretendimeve Gjykata kufizohet në identifikimin e gabimeve ligjore e faktike të dukshme, që shkojnë përtej pretendimeve për interpretim të gabuar të ligjit, që mbetet në kompetencë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 11, datë 11.2.2026, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkuësve, që lidhen me interpretimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në përcaktimin e shumës së dëmshpërblimit si pasojë e humbjes së jetës së familjarëve, si dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata do të analizojë nëse kërkuësit kanë marrë përgjigje për kërkimin e tyre, duke shqyrtuar nëse vendimi i Gjykatës së Lartë përmban



elemente arbitrariteti nga pikëpamja ligjore, të tilla që vënë në dyshim *të drejtën për të pasur një gjykim të drejtë*.

28. Sikurse u parashtrua në rrethanat e çështjes, kërkesit i janë drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesëpadi duke paditur shoqërinë e sigurimit për pagimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, shpenzimet e tjera të arsyeshme e të nevojshme dhe kamatëvonesat për shkak të dëmit të shkaktuar nga aksidenti automobilistik i ndodhur në datën 9.4.2007, ku si pasojë kanë gjetur vdekjen fillimisht shtetasi Kristaq Lina e më vonë për shkak të vetëvrasjes, pasi kishte humbur plotësisht aftësinë për punë edhe shtetasi Julian Lina (*shih paragrafin 4 të vendimit*). Pasi çështja është kthyer për rigjykim nga gjykata e apelit (*shih paragrafët 6-7 të vendimit*), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë duke caktuar vlerën përkatëse të dëmshpërblimeve, e cila është ndarë fillimisht për shkak të dëmit të pësuar si pasojë e vdekjes së Kristaq Linës, duke pasur parasysh marrëdhëniet familjare me gruan Zoica Lina dhe djalin Ilirjan Lina. Pjesa tjetër e vlerës iu është dhënë si dëmshpërblim për humbjen e jetës së Julian Linës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë për kërkimin për pagimin e kamatëvonesave. Pas ankimit të palëve ndërgjyqëse, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke detyruar shoqërinë e sigurimit të dëmshpërblejë kërkesit për dëmin pasuror dhe jopasuror në shumën totale 12.115.957 lekë (dymbëdhjetë milionë e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) dhe rrëzimin e padisë për kamatëvonesat (*shih paragrafin 8 të vendimit*). Kërkesit kanë ushtruar rekurs ku, mes të tjerave, kishin parashtruar pretendime për: i. zbatimin e gabuar të ligjit specifik në fushën e sigurimeve dhe të nenit 27 të rregullores nr. 622/1, datë 15.12.1992; ii. riçeljen e hetimit gjyqësor në gjykatën e apelit, pasi është bërë në kundërshtim me ligjin dhe nuk është zbatuar parimi i kontradiktoritetit sepse nuk është krijuar mundësia për t'i drejtuar pyetje ekspertit; iii. gjykimin në gjykatën e apelit, pasi janë rrëzuar kërkesat për përjashtimin e trupit gjykues dhe të ekspertit, ndërkohë që përjashtimi i trupit gjykues është kërkuar për arsye se nuk ka cituar në mënyrë të detajuar të gjitha shkaqet e ankimit dhe relatori është shprehur “pala paditëse besoj nuk ka pyetje për ekspertin”; iv) masën e dëmshpërblimit për Julian

Linën, pasi duhet t'i shtohet edhe masa e shpërblimit për periudhën e paftësisë; v. gjykatat më të ulëta, pasi kanë gabuar në qëndrimin e tyre për kamatëvonesat.

29. Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë për kërkimin në lidhje me interesat për shumën e dëmshpërblimit, duke detyruar shoqërinë e sigurimit të paguajë interesat për vlerën totale të dëmshpërblimit të caktuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, sipas normës së interesit bazë të depozitës sipas Bankës së Shqipërisë. Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, e ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së apelit për ligjin e zbatueshëm. Gjithashtu, Gjykata e Lartë e ka gjetur të pabazuar në ligj qëndrimin e gjykatave më të ulëta për pagesën e kamatëvonesave, duke vlerësuar se e drejta për të kërkuar kamatëvonesat është në vetvete një e drejtë me natyrë ligjore dhe nuk është e kushtëzuar me momentin kohor të ngritjes së kërkesëpadisë dhe se përmbaruesi gjyqësor në momentin e ekzekutimit duhet të llogarisë kamatëvonesat në bazë të përqindjes së normës bazë të interesit të miratuar nga Banka e Shqipërisë (*shih paragrafin 9 të vendimit*).

30. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka interpretuar ligjin e zbatueshëm në koherencë me rrethanat e çështjes, mbi bazën e të cilave ka arritur në mënyrën e zgjidhjes së çështjes, duke përcaktuar ligjin e zbatueshëm për përcaktimin e vlerës së dëmshpërblimit dhe duke i dhënë të drejtë kërkesve edhe për kërkimin e kamatëvonesave, pavarësisht se ky kërkim nuk ishte bërë në momentin fillestar të paraqitjes së kërkesëpadisë, ndryshe nga qëndrimi i mbajtur nga gjykatat më të ulëta. Gjykata konstaton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në respektim edhe të *parimit të subsidiaritetit*, ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së apelit lidhur me metodologjinë e përcaktimit të shpërblimit të dëmit pasuror dhe jopasuror, duke iu referuar dekretit nr. 295/1992, rregullores të dalë për zbatimin e tij për përcaktimin e dëmit pasuror, si dhe vendimit unifikues nr. 12/2007 për rregullimin e dëmit jopasuror, për shkak se për rregullimin e tij nuk ka asnjë parashikim si në dekret dhe rregullore. Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs nga kërkesit për ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e rastit konkret, për riçeljen e hetimit gjyqësor nga gjykata e apelit, gjë që



ka ndodhur në zbatim të nenit 465 të KPC-së dhe se ata kanë pasur mundësi t'i drejtojnë pyetje ekspertit, duke mos evidentuar shkelje procedurale. Ata kanë realizuar edhe të drejtën e tyre për kërkimin e shumave të shpërblimit dhe të kamatëvonesave, për shkak të humbjes së jetës së familjarëve të tyre. Gjithashtu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur edhe kriteret që do të mbahen parasysh në llogaritjen e interesave, që do të jetë norma e interesit bazë të depozitës (sipas llojit të saj), bazuar në përcaktimet e Bankës së Shqipërisë. Nën këtë optikë, Gjykata vlerëson se pjesa arsyetuese e vendimit të Gjykatës së Lartë ka respektuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, duke garantuar në këtë mënyrë edhe thelbin e *së drejtës së jetës*, të parashikuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së, në kuptim të garantimit të së drejtës për dëmshpërblim të përshtatshëm për familjarët e viktimës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se interpretimi i ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Lartë nuk është haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar, duke mos u evidentuar gabime të dukshme ligjore.

31. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e *së drejtës për gjykim të drejtë* është i pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.1.2026.

Shpallur më 19.3.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Asim Vokshi

VENDIM

Nr. 20, datë 24.2.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 24.2.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 10 (Sh) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shadije Lika

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria E Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 158, datë 6.2.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-312, datë 27.2.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 32, paragrafi 2, 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses Shadije Lika (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Dibër (*DRSSH-ja, Dibër*) ka paraqitur kallëzim penal ndaj kërkukses, për shkak se nga një hetim i auditimit të brendshëm ka rezultuar se ajo ka përfituar në mënyrë të padrejtë pension pleqërie duke përdorur dokumente të falsifikuara. Sipas procesverbalit të auditimit të datës 15.5.2015 ka rezultuar se kërkuësja ka përfituar pension pleqërie me vendimin e datës 20.5.1997 të DRSSH-së, Dibër, si nënë me shumë fëmijë, me periudhë sigurimi 24 vjet e 1 muaj, me efekte financiare nga data 1.3.1997 dhe masë pensioni 3.250 lekë. Gjatë procesit të auditimit është konstatuar mospërputhje e periudhave të sigurimit, pasi ka rezultuar se përfitimi i kërkukses ishte lidhur sipas pasqyrimit të librezës së punës të lëshuar nga Ndërmarrja e Furnizimit të Punëtorëve, Krastë (*NFP-ja, Krastë*), ku pasqyrohej periudha e punës 6.1.1965–31.12.1988. Ndërkohë, nga verifikimi i bazës të të dhënave të digjitalizuara, ka rezultuar se emri i kërkukses figuronte i regjistruar në ish-kooperativën Laç, Bruç, me periudhë sigurimi 1967-1990, e provuar kjo me vërtetimin nr. 781 prot, datë 14.5.2015 të DRSSH-së, Dibër. Po nga ky verifikim i bazës të të dhënave të digjitalizuara kërkuësja nuk figuronte e regjistruar në regjistrat e NFP-së, Krastë. Prokuroria ka arritur në konkluzionin se kërkuësja ka përfituar pension pa plotësuar kriteret ligjore sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit duhet të kishte plotësuar 19 vjet periudhë sigurimi ose vjetërsinë prej 15 vjetësh për të përfituar pension të pjesshëm pleqërie. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Dibër ka dërguar në gjyq çështjen në ngarkim të kërkukses, duke e akuzuar atë për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi në sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 55, datë 7.3.2018, ka vendosur pushimin e çështjes penale me nr. 278/15 akti, datë 20.11.2017, në ngarkim të kërkukses, për shkak se ndjekja penale për veprën penale “Mashtrimi në sigurime” nuk duhet të fillonte. Kjo gjykatë ka arsyetuar se kërkuësja nuk e ka konsumuar veprën

penale nga ana objektive. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 158, datë 6.2.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe deklarimin fajtorë të kërkukses për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi në sigurime” dhe dënimin e saj me 100.000 lekë gjobë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuësja.

4. Me vendimin nr. 00-2024-312, datë 27.2.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuësja, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Në datën 15.4.2025 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 18.6.2025 ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 24.6.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

6.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1.1. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi ndonëse kërkuësja ka paraqitur dokumentet zyrtare të lëshuara nga qendra e punës, si dhe dëshmitarët, gjykatat nuk i kanë marrë ato parasysh dhe nuk i kanë vlerësuar si prova në favor të saj. Ato nuk janë dokumente private të krijuara nga kërkuësja, por akte zyrtare të lëshuara nga nëpunës shteti të autorizuar nga ligji dhe brenda kompetencës së tyre dhe si të tilla përbëjnë provë të plotë. Në asnjë shkallë të gjykimit nuk është provuar se aktet janë të falsifikuara.

6.1.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat nuk kanë analizuar provat e paraqitura nga kërkuësja, vlerën e tyre në raport me vlerën e provave të prokurorisë. Në këtë mënyrë është shkelur edhe *e drejta e mbrojtjes*.



6.1.3. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk i kanë arsyetuar me hollësi pretendimet e kërkuësës dhe faktin se përse nuk kanë marrë parasysh aktet zyrtare dhe shkencore, por kanë keqinterpretuar faktet dhe ligjin. Vendimi i Gjykatës së Lartë është skematik, pa argumente, jologjik e jologjor dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura në rekurs nga kërkuësja.

6.1.4. *Parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi kërkuësja ka përfutur pension pleqërie në mënyrë të rregullt nga viti 2007 e në vazhdim dhe pas 10 vjetësh ai është ndërprerë me pretendimin se dokumentet e saj zyrtare janë cilësuar si të pavërteta.

6.2. *Parimin e prezumimit të pafajësisë*, pasi kërkuësja është dënuar mbi prova kontradiktore dhe të pavërtetuara përtej dyshimit të arsyeshëm. Të dyja provat e administruara janë të kundërta me njëra-tjetrën dhe gjykatat nuk i kanë sqaruar dhe verifikuar ato sipas ligjit. Kërkuësja ka paraqitur librezën e punës dhe vërtetimin e qendrës së punës si dokumente zyrtare të cilat përbëjnë provë të plotë dhe nuk janë shpallur të falsifikuara. Po kështu, pretendimet e saj janë mbështetur edhe nga dy dëshmitarë. Nga ana tjetër, prokuroria ka paraqitur si provë vërtetimin e lëshuar nga DRSSH-ja, Dibër, i cili është konsideruar i rregullt nga gjykatat, ndonëse nuk përmban gjeneralitetet e kërkuësës. Gjykatat nuk kanë bërë asnjë hetim shtesë ose akt ekspertimi që të vërtetojë se këto akte të paraqitura nga kërkuësja nuk janë të vërteta, por të falsifikuara, por kanë bërë një vlerësim ndryshe të tyre.

6.3. *Parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues*, të parashikuar nga neni 29, paragrafi 3, i Kushtetutës, për shkak të mosaplikimit të ligjit nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie” (*Ligji për dhënie amnistie*). Argumenti i Gjykatës së Lartë se kërkuësja nuk ka qenë subjekt i këtij ligji është i pabazuar, pasi fakti që çështja ishte pushuar në gjykatën e shkallës së parë nuk e përjashtonte atë, sepse vendimi nuk kishte marrë formë të prerë. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë, i cili i ka sugjeruar kolegjit pranimin e rekursit.

7. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim me argumentin e pamundësisë objektive, për shkak se Gjykata nuk i ka vënë në dispozicion dosjen gjyqësore mbi bazën e së cilës është deklaruar fajtores kërkuësja.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Për legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata është shprehur se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).



Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka pohuar se i takon, në radhë të parë, Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e çështjes së saj të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve (*shih Ibrahim i dhe të tjerë k. Shqipërisë, datë 14.1.2025, § 13*).

12. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i datës 27.2.2024, i cili është publikuar në faqen e kësaj gjykate në datën 4.4.2024. Kërkesa është paraqitur në datën 15.4.2025, ndërsa kërkesja ka parashtruar se është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 13.12.2024 në mënyrë rastësore, pasi asaj nuk i është komunikuar asnjëherë një kopje e vendimit dhe përfaqësuesi ligjor i ngarkuar me rekursin nuk e ka ndjekur çështjen. Për më tepër, kërkesja ka pretenduar se është 78 vjeç, me arsim 4-vjeçar, nuk ka adresë *e-mail* dhe nuk di të përdorë kompjuterin ose internetin për të ndjekur fatin e çështjes së saj.

13. Për sa më lart, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e GJEDNJ-së për detyrimin e Gjykatës së Lartë për njoftimin e vendimeve të saj dhe faktin se barra e provës në këtë drejtim nuk mund të rëndojë mbi kërkesen, Gjykata çmon se ajo legjitimohet *ratione temporis*.

14. Po kështu, Gjykata konstaton se pas njoftimit të palëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, kërkesja, në parashtrimet shtesë të datës 24.7.2025, ka pretenduar, gjithashtu, edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, me argumentin se ka përfutur pension pleqërie në mënyrë të rregullt nga viti 2007 e në vazhdim dhe pas 10 vjetësh ai është ndërprerë, pasi dokumentet e saj zyrtare janë cilësuar si të pavërteta.

15. Gjykata vëren se referuar nenit 1, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 185 të KPC-së, shkaqet e ankimit kushtetues individual mund të ndryshohen (shtohen ose pakësohen) deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Bazuar në këto parashikime, Gjykata çmon se ky pretendim i ri, i cili përbën shtesë të shkaqeve të ankimit kushtetues individual, nuk mund të merret në shqyrtim, pasi ai është paraqitur nga kërkesja pas vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

16. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkesja ka pretenduar se

vendimet gjyqësore i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe standardit të arsyetimit të vendimit, si dhe parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues.

17. Për sa i përket *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, kërkesja ka pretenduar se gjykatat nuk kanë analizuar provat e paraqitura nga kërkesja, vlerën e tyre në raport me vlerën e provave të prokurorisë, duke i cenuar edhe të drejtën e mbrojtjes. Gjithashtu, në lidhje me *parimin e gjykatës së caktuar me ligj*, kërkesja ka pretenduar se gjykatat nuk i kanë marrë parasysh provat e paraqitura prej saj dhe nuk i kanë vlerësuar në favor të saj. Sipas saj, në asnjë shkallë të gjykimit nuk është provuar se aktet janë të falsifikuara. Nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkeses, Gjykata çmon t'i analizojë ato në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë.

18. Lidhur me pretendimin për cenimin e *parimit të zbatimit të ligjit penal favorizues*, Gjykata vëren se kërkesja ka pretenduar se gjykatat nuk kanë aplikuar Ligjin për dhënie amnistie dhe se argumenti i Gjykatës së Lartë se kërkesja nuk ka qenë subjekt i këtij ligji është i pabazuar, pasi fakti që çështja ishte pushuar në gjykatën e shkallës së parë nuk e përjashtonte atë, sepse vendimi nuk kishte marrë formë të prerë. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë, i cili i ka sugjeruar kolegjit pranimin e rekursit.

19. Për sa i përket veprimtarisë së këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë, nisur nga fakti se në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se veprimtaria që ushtron ai ka karakter këshillues dhe ndihmës, në ndryshim nga ajo e gjyqtarit, e cila ka karakter vendimmarrës dhe se kontrolli kushtetues ushtrohet vetëm ndaj vendimeve gjyqësore (*shih vendimet nr. 49, datë 5.10.2023; nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*), ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Gjykata ka theksuar se parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Për më tepër, ky parim duhet të respektohet edhe në gjykimin që mund të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, sepse është pikërisht kjo Gjykatë që kontrollon



mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 1, datë 20.1.2014; nr. 35, datë 20.12.2005; nr. 14, datë 17.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata vëren se Ligji për dhënie amnistie në nenin 3 ka parashikuar, ndër të tjera, se plotësojnë kriteret për të përfutur amnisti: a) personat e dënuar me burgim deri në 3 vjet, personat e dënuar me kusht, me gjobë apo personat, për të cilët gjykata ka caktuar një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31 dhjetor 2013, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale, të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji; b) personat e dënuar, gra, qe, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 50 vjeç, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale, të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

22. Gjithashtu, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi procedimi penal është regjistruar në datën 19.7.2017 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe çështja ka qenë në gjykim për veprimet e kryera nga kërkuesja, konkretisht përfitimi në mënyrë të paligjshme i pensionit, edhe pas daljes së amnistisë. Sipas kësaj gjykate, kërkuesja është dënuar me gjobë sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë në datën 6.2.2019, ndërsa në shkallë të parë çështja ndaj saj ka qenë e pushuar. Në përfundim, ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuesja nuk ka qenë subjekt i Ligjit për dhënie amnistie dhe pretendimi i saj nuk është i drejtë.

23. Bazuar në sa më lart, Gjykata evidenton se kallëzimi penal ndaj kërkueses është paraqitur në datën 13.1.2016, hetimet ndaj saj kanë përfunduar në datën 16.10.2017, kur është dërguar për gjykim procedimi penal dhe me vendimin e datës 7.3.2018 të gjykatës së shkallës së parë është vendosur pushimi i çështjes penale. Ndërsa me vendimin e datës 6.2.2019 gjykata e apelit ka vendosur shpalljen fajtores të kërkueses. Gjykata vëren se kërkuesja i referohet ligjit për amnistinë të miratuar në vitin 2014, ndërkohë që procedimi dhe dënimi i saj rezultojnë respektivisht në vitet 2017 dhe 2019. Për më tepër, edhe Gjykata e Lartë i ka kthyer përgjigje këtij pretendimi, duke arritur në përfundimin se kërkuesja nuk ka qenë subjekt i Ligjit për amnistinë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses në këtë drejtim është haptazi i pabazuar,

duke mos arritur ajo të provojë cenimin e së drejtës për të përfutur nga ligji penal favorizues.

24. Për sa i takon pretendimeve për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe standardit të arsyetimit të vendimit, Gjykata vëren se ato bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohen në vijim në themel të ndërlidhura së bashku.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

25. Kërkuesja ka pretenduar se është dënuar mbi prova kontradiktore dhe të pavërtetuara përtej dyshimit të arsyeshëm, pasi të dyja provat e administruara janë të kundërta me njëra-tjetrën dhe gjykatat nuk i kanë sqaruar dhe verifikuar ato sipas ligjit. Sipas saj, dokumentet e paraqitura në gjykim, librezat e punës dhe vërtetimi i qendrës së punës, janë dokumente zyrtare të cilat përbëjnë provë të plotë dhe nuk janë shpallur të falsifikuara. Nga ana tjetër, sipas kërkueses, prokuroria ka paraqitur si provë vërtetimin e lëshuar nga DRSSH-ja, Dibër, i cili është konsideruar i rregullt nga gjykatat, ndonëse nuk përmban gjeneralitetet e saj. Po kështu, kërkuesja ka pretenduar edhe se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë arsyetuar me hollësi pretendimet e saj, nuk kanë marrë parasysh aktet zyrtare dhe shkencore, por kanë keqinterpretuar faktet dhe ligjin.

26. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim kushtetues ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 4 të KPP-së, i cili përcakton, gjithashtu, se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Në jurisprudencën kushtetuese parimi i prezumimit të pafajësisë është elaboruar në drejtim të faktit se gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Gjykatat duhet të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 68, datë 14.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i



fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Sipas këtij parimi, asnjë dënim ose masë që barazohet me të nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 8, datë 20.2.2024; nr. 12, datë 24.8.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa i përket së drejtës për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, Gjykata ka theksuar se, si pjesë e së drejtës për proces të rregullt ligjor, ajo garantohet nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Sipas Gjykatës, arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 8, datë 20.2.2024; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 63, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata do të verifikojë nëse në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkueses gjykatat e zakonshme kanë respektuar garancitë procedurale të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe nëse ato u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të saj në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit.

29. Në rastin konkret Gjykata vëren se kërkuesja është akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi në sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i KP-së, bazuar në kallëzimin penal të DRSSH-së, Dibër, e cila ka pretenduar se kërkuesja nëpërmjet përdorimit të dokumenteve të falsifikuara ka përfituar pension në mënyrë të padrejtë.

30. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka vendosur pushimin e çështjes penale, për shkak se ndjekja penale për këtë veprë nuk duhet të fillonte, me arsyetimin se kërkuesja nuk e ka konsumuar veprën penale nga ana objektive. Sipas kësaj gjykate, kërkuesja ka paraqitur kërkesë për të përfituar pension pleqërie pranë DRSSH-së, Dibër, duke depozituar librezën e punës të lëshuar nga NFP-ja, Krastë në datën 21.12.1988, nga ku, ndër të tjera,

pasqyrohet periudha e punës 6.1.1965–31.12.1988. Ndërkohë, nga vërtetimi nr. 781 prot, datë 14.5.2015, i lëshuar nga DRSSH-ja, Dibër, rezulton se: “Në bazë të dokumenteve që disponon arkivi i ISSH-së vërtetohet, se: Shadije z. Lika Hoxha, lindur më . . . në . . . , ka punuar në Rajonin Dibër, kooperativa bujqësore Laç, Bruç, sipas shënimeve të regjistrit nr. 03, fleta 118, nga viti 1967–1990.”. Në analizë të dokumenteve të paraqitura në gjykim, kjo gjykatë ka arritur në përfundimin se nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesja ka konsumuar nga ana objektive figurën e veprës penale për të cilën akuzohet, pasi, *së pari*, vërtetimi nr. 781 prot, datë 14.5.2015, lëshuar nga DRSSH-ja, Dibër, nuk provohet se i përket së pandehurës, pasi në të nuk është pasqyruar identiteti i saktë i personit të cilit i përket. *Së dyti*, fakti se kërkuesja ka punuar pranë NFP-së, Krastë vërtetohet nga librezja e punës e lëshuar prej saj në datën 21.12.1988, nga vërtetimi i datës 10.3.1997 i lëshuar nga Ndërmarrja Likuidatori i NFP-së, Krastë, ndërsa nga shkresa e DRSSH-së, Dibër rezulton se nuk është administruar dokumentacioni i plotë i NFP-së, Krastë dhe as listë pagesa. Për më tepër, dy dëshmitarë në gjykim kanë dëshmuar se kërkuesja ka punuar pranë NFP-së, Krastë nga viti 1984 deri në 1995.

31. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe deklarin fajtor të kërkueses për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi në sigurime” dhe dënimin e saj me 100.000 lekë gjobë, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë nuk ka çmuar provat në kuptim të nenit 152 të KPP-së. Më konkretisht, vërtetimi i DRSSH-së, Dibër nr. 781 prot, datë 14.5.2015 nuk është analizuar drejt, pasi ai provon se kërkuesja ka qenë punonjëse e ish-kooperativës Laç, Bruç dhe nuk mund të ishte njëkohësisht e punësuar dhe në një ndërmarrje tjetër. Po kështu, nga aktet shkresore është provuar se NFP-ja, Krastë ka regjistra të punëtorëve dhe emri i kërkueses nuk figuron në këta regjistra. Edhe dy dëshmitarët nuk japin të dhëna bindëse dhe pohimi i tyre nuk lidhet me asnjë provë tjetër të marrë në këtë gjykim.

32. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim dhe interpretim të drejtë të ligjit penal material dhe procedural penal. Ai e ka gjetur të pabazuar pretendimin e kërkueses për zbatim të gabuar të ligjit penal në drejtim të ekzistencës së faktit penal të atribuuar dhe cilësimit të tij juridik. Sipas këtij



kolegji, gjykata e apelit ka analizuar veprimet e kërkuases, duke çmuar provat në raport me faktin penal dhe akuzën e atribuuar asaj, vendimmarrja e saj është e arsyetuar dhe janë analizuar në tërësi veprimet e kërkuases, duke konkluduar për fajësinë e saj në përputhje me standardin përtej dyshimit të arsyeshëm. Kolegji Penal ka vlerësuar të drejtë edhe vendimmarrjen e gjykatës së apelit për sa i përket caktimit të llojit dhe masës së dënimit. Në përfundim, sipas këtij kolegji, gjykata e apelit ka arsyetuar në mënyrë shteruese elementet e veprës penale në raport me veprimet dhe mosveprimet e kryera nga kërkuësja, bazuar në rrethanat dhe në provat e verifikuara në këtë gjykim dhe me të drejtë i ka gjetur të bazuara pretendimet e paraqitura në ankim nga prokuroria, duke bërë një çmuarje të drejtë të provave referuar nenit 152 e vijuese të KPP-së. Pra, sipas Kolegjit Penal, në verifikimin e shkaqeve të rekursit nuk konstatohet mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk evidentohet mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk rezulton që vendimi i ankimuar është në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

33. Nisur nga sa më lart, në kuadrin e rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vëren se gjykata e apelit, ndonëse e ngarkuar me ligj për të shqyrtuar çështjen në aspektin faktik, nuk është ndalur në shqyrtimin dhe analizimin e plotë të provave të paraqitura nga kërkuësja, të cilat, sipas saj, provonin ekzistencën e marrëdhënies së punës. Në këtë këndvështrim, Gjykata rithekson se vlerësimi i provave është atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa juridiksionit kushtetues i takon të verifikojë nëse, gjatë këtij vlerësimi, janë respektuar standardet kushtetuese, përfshirë parimin e prezumimit të pafajësisë.

34. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se, si rregull, barra e provës për ekzistencën e elementeve të veprës penale rëndon mbi organin e prokurorisë. Në rastin konkret, gjykata e apelit nuk rezulton të ketë analizuar faktin nëse prokuroria ka provuar se kërkuësja, për përfitimin e pensionit, kishte përdorur dokumente me përmbajtje të pavërtetë, konkretisht librezën e punës dhe vërtetimin e Ndërmarrjes Likuidatori të NFP-së, Krastë. Pra, kjo gjykatë nuk

ka arritur të argumentojë faktin se ky dokument i prejardhur vërteton përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se dokumentet e paraqitura prej kërkuases – si mjete të supozuara si të përdorura për kryerjen e veprës penale – kanë përmbajtje të pavërtetë.

35. Nisur nga kjo premisë, Gjykata evidenton se të tria dokumentet në fjalë, përfshirë edhe dokumentin e prejardhur (duke pranuar se ai përkon me regjistrin e vjetërsisë në punë në kooperativë), përbëjnë dokumente zyrtare me fuqi të plotë provuese deri në provimin e së kundërtës. Megjithatë, gjykata e apelit ka pranuar si provë vendimtare vërtetimin nr. 781 prot., datë 14.5.2015 të DRSSH-së, Dibër, si dhe mungesën e të dhënave në regjistrat e ndërmarrjes, pa arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme përse njërit dokument i është njohur fuqi e plotë provuese, ndërsa dy të tjerëve jo. Ajo ka lënë të nënkuptohet se librezë e punës dhe vërtetimi i ndërmarrjes janë, të paktën intelektualisht të falsifikuara, pa administruar prova të drejtpërdrejta për pavërtetësinë e tyre si dhe pa sqaruar se çfarë konsiderohet “intelektualisht të falsifikuara” në raport me këto dokumente dhe cilat kanë qenë veprimet e kryera nga kërkuësja për të realizuar këtë falsifikim. Po kështu, Gjykata konstaton se gjykata e apelit nuk ka analizuar nëse dokumentacioni arkivor i ndërmarrjes është i plotë dhe i besueshëm, sidomos në kushtet kur gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ky dokumentacion rezulton i paplotë. Ekzistenca e një dyshimi për plotësinë ose mangësinë e arkivit nuk mund të interpretohet në disfavor të kërkuases, pasi një dyshim i tillë, në dritën e parimit *in dubio pro reo*, duhet të shkojë në favor të saj.

36. Nga mënyra e arsyetimit të gjykatës së apelit, Gjykata vlerëson se kërkuësja i është ngarkuar, në mënyrë të nënkuptuar, barra për të provuar pavërtetësinë e dokumentit të prejardhur të lëshuar nga institucionet përkatëse ose për të vërtetuar më tej ekzistencën e marrëdhënies së punës. Një qasje e tillë përbën përmbysje të barrës së provës, në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi është detyrë e organit të prokurorisë të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm si pavërtetësinë e dokumenteve, ashtu edhe elementet e tjera të veprës penale.

37. Gjithashtu, Gjykata konstaton se kërkuësja këto pretendime i ka ngritur edhe në rekurs, duke argumentuar se gjykata e apelit ka analizuar vetëm provat që mbështesnin akuzën, duke lënë pa trajtuar në mënyrë të argumentuar provat në favor të saj dhe



duke mos provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm elementet e veprës penale. Megjithatë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është mjaftuar me konstatimin e përgjithshëm se gjykata e apelit ka bërë një çmuarje të drejtë të provave dhe një interpretim të saktë të ligjit, duke e konsideruar çështjen si të lidhur me vlerësimin e provave dhe, për rrjedhojë, jashtë kontrollit të tij rishikues ekskluzivisht ligjor. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka mbajtur një qasje formaliste, pa analizuar nëse standardi kushtetues i provueshmërisë së fajësisë dhe rregullat mbi barrën e provës janë respektuar nga ana e gjykatës së apelit.

38. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se, duke mos mbajtur një qëndrim të shprehur dhe substancial për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, në veçanti lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë, standardin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe ndalimin e përmbysjes së barrës së provës, Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur standardin e arsytimit të vendimit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësës për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit është i bazuar.

39. Në përfundim, Gjykata çmon se, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj ajo pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-312, datë 27.2.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 24.2.2026.

Shpallur më 19.3.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Asim Vokshi, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 21, datë 3.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 3.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 22 (A) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Alket Çela

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Ajencia e Trajtimit të Pronave, në mungesë.

Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, përfaqësuar nga avokatet e shtetit Irma Qosja dhe Valbona Legisi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-5007, datë 17.12.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes nr. 14229 (31138-001164-86-2021), datë 9.4.2021, nga Gjykata Administrative e Apelit brenda një afati të arsyeshëm.

Urdhërimi i marrjes së masave të nevojshme dhe të domosdoshme për gjykimin sa më të shpejtë të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Alket Çela (*kërkuari*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, Agjencisë së Trajtimin të Pronave (ATP), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor dhe përfaqësuesit të trashëgimtarëve të ish-pronarit A.Ç. (M.), i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, me objekt vlerësimin financiar të vendimit nr. 184, datë 26.6.2009 të ish-Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Tiranë (ZRKKP-ja, Tiranë) në emër të subjektit të shpronësuar, me palë të paditur ATP-në, e cila është përfaqësuar në gjykim nga Avokatura e Përgjithshme e Shtetit.

2. Me vendimin nr. 364 (80-2021-377), datë 15.2.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, vlerësimin financiar të vendimit nr. 184, datë 26.6.2009 të ZRKKP-së, Tiranë për sipërfaqen 39.000 m² të llojit “tokë bujqësore”, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 2291, fshati Kryemëdhenj, ish-komuna Golem, i Bashkisë Kavajë, në shumën 12.831.000 lekë dhe detyrimin e palës së paditur të bëjë pasqyrimin e vendimit në regjistrin e vendimeve përfundimtare të kompensimit. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim pala e paditur, ATP-ja, si dhe Avokatura e Shtetit.

3. Çështja është regjistruar për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 14229 (31138-01164-86-2021), datë 9.4.2021. Në datat 23.1.2024 dhe 2.10.2024 kërkuari i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesa për përshpejtimin e gjykimit të çështjes bazuar në vendimin nr. 78, datë 30.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit” (*vendimi nr. 78/2019 i KLGJ-së*). Më pas, në datën 6.11.2024, kërkuari i është drejtuar Gjykatës së

Lartë me kërkesë me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 399/1, 399/2, pikat 1, shkronja “a” dhe 2, si dhe 399/6, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-5007, datë 17.12.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se çështja nuk është pezulluar ose shtyrë gjykim për shkak të kërkesave të palës kërkuare, nuk konstatohet ndonjë sjellje e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit e deri në ato momente nuk është kryer ndonjë veprim procedural, si dhe çështja nuk paraqitet komplekse nga natyra e saj. Ndërsa mosveprimi i gjykatës së apelit ka ardhur si rezultat i volumit të madh të çështjeve, të mbetura pa gjykuar për një kohë të gjatë, në raport me një pamjaftueshmëri burimesh njerëzore për të përballuar këtë volum, sepse një situatë e tillë e vë organin gjyqësor në kushtet e pamundësisë objektive për procedim dhe ka të bëjë me një problematikë që përfshin sistemin në tërësi. Po kështu, mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive, që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Gjyqtari relator ka deklaruar se është deleguar në atë gjykatë në muajin tetor të vitit 2023 dhe për shqyrtimin e çështjes zbaton rendin kronologjik.

5. Në datën 1.4.2025 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të Ligjit Organik të saj, është regjistruar në datën 17.4.2025. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 18.6.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 24.6.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në datën e planifikuar për zhvillimin e seancës gjyqësore, në gjykimin e çështjes nuk ka marrë pjesë një gjyqtar për arsye objektive të lidhura me ushtrimin e detyrës.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt*



ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e:

6.1. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja e regjistruar në datën 9.4.2021 në Gjykatën Administrative të Apelit nuk është shqyrtuar ende, duke tejkaluar afatin e përcaktuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së. Kërkuesi ka paraqitur kërkesa për përshpejtimin e gjykimit, bazuar në vendimin nr. 78/2019 të KLGJ-së, kërkesa të cilat janë refuzuar.

6.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë ka rrefuzuar kërkesën për konstatimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm pa analizuar interesat kushtetues të pronësisë dhe rrethanat e ecurisë së kësaj çështjeje në organet administrative dhe gjyqësore. Në këtë vendim nuk është analizuar as rreziku që pasjell te jzgjatja e afateve të gjykimit, por kjo te jzgjatje është përligjur nga Gjykata e Lartë, duke e lënë çështjen në diskrecion të Gjykatës Administrative të Apelit sipas rendit kronologjik. Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur në konsideratë qëndrimin e Gjykatës se ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që justifikon vonesën në gjykim.

7. Subjekti i interesuar, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, ka prapësuar si vijon:

7.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në aspektin e *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm* është i pabazuar, pasi kërkuesi nuk ka arritur të paraqesë argumente të mjaftueshme për të provuar cenimin e kësaj të drejte. Afati i gjykimit të çështjes formalisht ka tejkaluar afatin 1-vjeçar të përcaktuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së. Për sa i përket sjelljes së kërkuetit, nuk rezulton që çështja të jetë pezulluar ose shtyrë për shkak të kërkesave të palëve, pra sjellja e tij nuk ka ndikuar në kohëzgjatjen e procesit. Çështja objekt gjykimi ka natyrë administrative, me objekt vlerësimin financiar të vendimit të ZRKKP-së, Tiranë në emër të subjektit të shpronësuar dhe nuk është komplekse. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve, nuk mund të konstatohet shkelje e afatit të arsyeshëm, për sa kohë vonesa në gjykimin e çështjes vjen si pasojë e pamundësisë objektive dhe jo për shkak të neglizhencës së gjyqtarit ose administrimit të parregullt gjyqësor. Po kështu, për sa kohë çështja e kërkuetit ka të bëjë me vlerësimin financiar të vendimit të ZRKKP-së, Tiranë, ai nuk ka arritur të argumentojë ose provojë sesi interesi i tij rrezikohet për shkak të vonesës së

gjykimit në gjykatën e apelit. Çështja lidhet me interesa vetjakë, siç është e drejta e pronës, por jo me interesa jetësorë, të tillë që do të kërkonin shqyrtimin me përparësi të saj në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

7.2. Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i pabazuar, pasi vendimmarrja e Gjykatës së Lartë është e arsyetuar, ezaauruese dhe e mbështetur në dispozitat procedurale civile, si dhe respekton objektin e kërkesës.

8. Subjekti i interesuar, ATP-ja, nuk ka paraqitur shpjegime me shkrim, ndonëse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, kërkuesi, bazuar në nenet 399/1 e vijuese të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, kërkesë e cila është



rrëzuar me vendimin nr. 00-2024-5007, datë 17.12.2024. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuarit për rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

12. Kërkuar legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm është i datës 17.12.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 1.4.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës.

13. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë janë në funksion të pretendimit kryesor për tejzgjatjen e procedurave gjyqësore, i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

14. Kërkuar ka pretenduar se çështja e regjistruar në datën 9.4.2021 në Gjykatën Administrative të Apelit nuk është shqyrtuar ende, duke tejkaluar afatin e përcaktuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së dhe ndonëse ai ka paraqitur kërkesa për përsheptim, bazuar në vendimin nr. 78/2019 të KLGJ-së, ato janë refuzuar. Sipas kërkuarit, Gjykata e Lartë ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm pa analizuar interesat kushtetues të pronësisë dhe rrethanat e ecures së kësaj çështjeje në organet administrative dhe gjyqësore. Sipas kërkuarit, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar as rrezikun që passjell tejzgjatja e afateve të gjykimit, por kjo tejzgjatje është përligjur prej saj, duke e lënë çështjen në diskrecion të Gjykatës Administrative të Apelit sipas rendit kronologjik. Po kështu, sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur në konsideratë qëndrimin e Gjykatës se ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që justifikon vonesën në gjykim.

15. Subjekti i interesuar, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, ka prapësuar se pretendimi i kërkuarit është i pabazuar, pasi ai nuk ka arritur të

paraqesë argumente të mjaftueshme për të provuar cenimin e kësaj të drejte. Ndonëse afati i gjykimit të çështjes formalisht ka tejkaluar afatin 1-vjeçar të përcaktuar në dispozitën procedurale civile, çështja nuk rezulton të jetë pezulluar ose shtyrë për shkak të kërkesave të palëve dhe ajo nuk paraqitet komplekse. Gjithashtu, nuk mund të konstatohet shkelje e afatit të arsyeshëm për sa kohë vonesa në gjykimin e çështjes vjen si pasojë e pamundësisë objektive dhe jo për shkak të neglizhencës së gjyqtarit ose administrimit të parregullt gjyqësor. Po kështu, sipas subjektit të interesuar, për sa kohë çështja ka të bëjë me vlerësimin financiar të vendimit të ZRKKP-së, Tiranë, kërkuar nuk ka arritur të argumentojë ose provojë sesi interesi i tij rrezikohet për shkak të vonesës së gjykimit në gjykatën e apelit. Çështja lidhet me interesa vetjakë, siç është e drejta e pronës, por jo me interesa jetësorë, të tillë që do të kërkonin shqyrtimin me përparësi të saj në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

16. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përfshihen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuar i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, me objekt vlerësimin financiar të vendimit nr. 184, datë 26.6.2009 të ZRKKP-së, Tiranë në emër të subjektit të shpronësuar, me palë të paditur ATP-në. Kjo gjykatë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, vendim i cili është ankimuar nga pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 9.4.2021, pra deri në momentin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual kanë kaluar rreth 4 vjet e 10 muaj dhe ende nuk ka një vendimmarje për themelin e saj.

18. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka theksuar se neni 48 i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat



administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjyimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjyimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

19. Gjykata ka pohuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave, në kuptim të rrethanave të veçanta të çështjes konkrete, vlerësohet nën dritën e këtyre kriterëve: (i) sjellja e kërkuarit; (ii) kompleksiteti i çështjes; iii. sjellja e autoriteteve; iv. rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuar.

20. Gjykata thekson se, për sa u përket kriterëve që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkuarit, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të saj për vlerësimin e tyre (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*), nuk konstatohet ndonjë shkak ose rrethanë e re, ose e ndryshme për të arritur ajo në një qëndrim të ndryshëm për sa i përket respektimit të tyre. Për rrjedhojë, për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, Gjykata vlerëson të ndalet në vijim vetëm në analizën e kriterit të *asaj se çfarë rrezikon kërkuar* në rastin konkret për shkak të vonesave në gjykimin e çështjes së tij.

21. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tillë si ata që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuarit verifikohet rast pas rasti (*shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në analizë të kriterëve si më sipër, Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim thelbi i çështjes gjyqësore të vënë në lëvizje nga kërkuar ka të bëjë me vlerësimin financiar të një prone të njohur ish-pronarit të shpronësuar me vendim të ZRKKP-së, Tiranë. Kjo çështje, sikurse ka pranuar subjekti i

interesuar, për nga natyra e saj, edhe pse nuk lidhet drejtpërdrejt me interesa jetësorë, që kërkojnë trajtim me përparësi, lidhet me të drejtën e pronës dhe proceset e kthimit dhe kompensimit të pronave. Për këto të fundit, Gjykata ka pohuar se shqyrtimi i këtyre çështjeve kërkon trajtim me përparësi për shkak të interesit që ato paraqesin për kërkuar (*shih vendimet nr. 75, datë 20.11.2025; nr. 2, datë 21.1.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, Gjykata vëren se kërkuar i është drejtuar disa herë gjykatës së apelit me kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, duke parashtruar se trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar janë pensionistë dhe në gjendje të rënduar shëndetësore. Në këto rrethana, Gjykata, duke marrë në konsideratë veçoritë e çështjes konkrete, si edhe rëndësinë e interesave që mund të cenohen nga zgjatja e procesit gjyqësor, vlerëson se është provuar ekzistenca e një rreziku real për interesat e kërkuarit, natyra e të cilit justifikon trajtimin me përparësi të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

23. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe qëndrimin të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet si një kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile që nuk kërkojnë ndonjë trajtim të veçantë prioritar, kanë megjithatë të drejtë, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm dhe ato nuk janë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale. Sipas asaj gjykate, një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet e arsyeshme kur argumenti i vetëm për vonesën është reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve e krijuar për këtë shkak dhe faktorë të tillë të një natyre të përgjithshme mund të merren parasysh në një masë të përshtatshme në përcaktimin e çdo kohëzgjatjeje të procedurave në një çështje të veçantë, por nuk janë të afta, në vetvete, të justifikojnë vonesa të një mase të tillë (*shih ARB sh.p.k. e të tjerë kundër Shqipërisë, datë 27.05.2025, §§§ 111, 118, 122*).

24. Në këtë këndvështrim, Gjykata, duke pasur parasysh se çështja ka mbetur në pritje të shqyrtimit në Gjykatën Administrative të Apelit për një periudhë prej 4 vjetësh e 10 muajsh (e regjistruar në datën 9.4.2021), arrin në përfundimin se është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Për



rrjedhojë, vendimi nr. 00-2024-5007, datë 17.12.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet. Gjithashtu, për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se çështja e kërkesit duhet të shqyrtohet me përparësi nga Gjykata Administrative e Apelit.

25. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuarit duhet të pranohet sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-5007, datë 17.12.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
 3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 3.3.2026.

Shpallur më 19.3.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë

